


Tregtia e jashtme e mallrave

Maj 2022

Tiranë, më 17 Qershor 2022: Në Maj 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 45 mld lekë, duke u rritur me 36,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 6,9 %, në krahasim me Prill 2022. Importet e mallrave arritën vlerën 80 mld lekë, duke u rritur me 28,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 2,3 %, në krahasim me Prill 2022. Deficiti tregtar i këtij muaji është 35 mld lekë, duke u rritur me 19,4 %, krahasuar me Maj 2021 dhe ulur me 3,0 %, në krahasim me Prill 2022.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë pesëmuajor eksportet e mallrave arritën vlerën 207 mld lekë, duke u rritur me 46,0 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 365 mld lekë, duke u rritur me 27,1 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 158 mld lekë, duke u rritur me 8,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Maj 2022, në rritjen e eksporteve prej 36,8 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +13,1 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +9,1 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me 6,7 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Maj 2022




Eksportet, gjatë këtij pesëmuajori janë rritur me 46,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +14,4 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +14,4 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me 7,6 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Maj 2022, në rritjen e importeve prej 28,6 %, krahasuar me Maj 2021, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +8,9 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +5,0 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +4,5 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Maj 2022



Si pesëmuajor, importet janë rritur me 27,1 %, krahasuar me pesëmuajorin e parë 2021. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,6 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +4,0 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Maj 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Maj 2021 janë: Itali (59,4 %), Gjermani (66,9 %) dhe Greqi (26,0 %). Vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova (21,7 %) dhe Spanja (90,6 %).

Gjatë këtij pesëmuajori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (58,6 %), Gjermania (105,8 %) dhe Kosova (15,8 %). Vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Spanja (75,4 %) dhe Rusia (47,2 %).

Në muajin Maj 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Maj 2021 janë: Italia (15,5 %), Turqia (33,2 %) dhe Kina (30,4 %). Vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Rusia (43,1 %) Spanja (11,6 %) dhe Ukrainë (5,6 %).

Gjatë këtij pesëmuajori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (14,1 %), Turqia (53,7 %) dhe Greqia (24,4 %). Vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: SHBA (10,0 %), Rusia (20,0 %) dhe Zvicra (17,9 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Maj 2022



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 61,0 %, të gjithë tregtisë. Në Maj 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,9 %), Turqia (7,5 %), Gjermania (6,2 %) dhe Greqia (6,2 %).

Shkëmbimet tregtare, për pesëmuajorin 2022, me vendet e BE-së zënë 61,0 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Maj 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,1 %), Turqia (8,6 %), Gjermania (6,8 %) dhe Greqia (6,6 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Maj 2022

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2021		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	Janar– Maj 19	127	-3,5	264	3,5	-137	48,0
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	Janar– Maj 20	102	-19,3	219	-17,0	-117	46,7
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	Janar – Maj 21	142	38,6	287	30,9	-145	49,4
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	Janar– Maj 22	207	46,0	365	27,1	-158	56,7

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Maj 2022

	Eksporte				Importe			
	Maj 2021	Maj 2022	Jan, - Maj 2021	Jan, - Maj 2022	Maj 2021	Maj 2022	Jan, - Maj 2021	Jan, - Maj 2022
Vendet e BE-së	22.982	32.677	103.451	151.614	35.275	43.370	162.315	197.055
Austri	184	369	902	1.647	576	653	2.529	2.703
Gjermani	1.603	2.675	7.691	15.827	4.142	5.069	20.674	23.192
Greqi	1.758	2.216	7.673	9.772	4.583	5.522	22.460	27.941
Itali	13.460	21.455	61.458	97.469	16.963	19.596	75.269	85.904
Spanjë	2.463	233	9.612	2.361	1.106	977	3.978	5.565
Kroaci	205	502	1.177	3.552	663	868	2.812	3.136
Të tjera të BE-së	3.308	5.227	14.938	20.987	7.243	10.685	34.593	48.613
Mbretëri e Bashkuar	44	210	237	724	529	875	2.260	3.081
Kinë	466	781	3.281	6.038	4.544	5.927	25.320	27.403
Kosovë	3.834	3.002	13.656	15.810	944	1.212	3.800	5.953
Maqedonia e Veriut	1.194	1.404	4.286	7.537	941	1.805	4.301	6.624
Rusi	8	-	8	4	2.211	1.259	5.953	4.760
SHBA	376	606	1.902	4.671	1.146	1.547	5.459	4.910
Turqi	560	937	2.555	2.891	6.357	8.469	30.232	46.471
Ukrainë	9	36	147	242	298	281	1.470	1.793
Zvicër	216	770	1.060	1.967	499	663	3.956	3.247
Të tjera	3.169	4.509	11.190	15.494	9.200	14.263	41.968	63.578
Gjithsej	32.857	44.932	141.773	206.993	61.942	79.670	287.034	364.875

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Maj 2022

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Maj 2021	Maj 2022	Jan, - Maj 2021	Jan, - Maj 2022	Maj 2021	Maj 2022	Jan, - Maj 2021	Jan, - Maj 2022
Gjithsej	32.857	44.932	141.773	206.993	61.942	79.670	287.034	364.875
Ushqime, pije, duhan	4.428	5.244	16.890	20.318	10.705	13.502	46.705	58.267
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	6.614	9.594	27.484	47.895	5.410	10.940	25.145	55.912
Produkte kimike dhe plastike	821	1.161	3.830	6.992	9.440	10.756	45.174	46.789
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	172	285	853	1.270	1.610	1.717	5.899	7.588
Prodhime druri dhe letre	742	1.288	3.561	5.637	2.074	3.259	10.144	13.957
Tekstile dhe këpucë	9.761	11.956	45.664	56.390	8.064	9.531	34.692	41.229
Materiale ndërtimi dhe metale	6.773	11.078	27.906	48.258	9.020	10.932	41.103	57.266
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	2.581	3.271	11.428	15.310	12.865	15.973	65.464	70.608
Të tjera	964	1.056	4.156	4.922	2.755	3.059	12.708	13.260

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Maj 2022

	Itali		Kosovë		Gjermani		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	61.458	97.469	13.656	15.810	7.691	15.827	7.673	9.772
Ushqim, pije duhan	4.289	4.648	1.606	2.135	523	712	1.509	1.587
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	685	15.400	3.233	2.690	2.348	9.518	2.242	1.333
Produkte kimike dhe plastike	975	1.949	1.224	1.838	34	19	304	434
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	734	1.185	8	6	29	2	8	16
Prodhime druri dhe letre	2.294	3.459	312	564	97	145	487	844
Tekstile dhe këpucë	36.190	44.377	83	83	3.051	3.536	2.068	2.373
Materiale ndërtimi dhe metale	8.551	15.698	5.997	7.218	503	705	814	2.773
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	5.742	8.275	585	698	930	1.011	43	66
Të tjera	1.998	2.478	607	578	175	179	198	346

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Maj 2022

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	75.269	85.904	30.232	46.471	25.320	27.403	22.460	27.941
Ushqim, pije duhan	9.112	11.132	2.730	2.840	369	539	6.474	7.431
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.954	2.680	1.305	3.577	8	2	3.123	5.258
Produkte kimike dhe plastike	9.734	10.784	4.242	4.809	3.695	2.794	3.667	4.125
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	4.982	6.150	132	216	249	351	14	10
Prodhime druri dhe letre	2.478	3.099	1.250	2.388	285	392	1.433	1.840
Tekstile dhe këpucë	16.649	21.024	6.785	7.526	4.468	4.321	1.321	1.821
Materiale ndërtimi dhe metale	10.178	11.144	7.538	18.154	1.970	3.198	4.270	5.009
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	15.594	16.791	4.129	4.923	11.854	13.033	1.302	1.796
Të tjera	2.588	3.101	2.120	2.039	2.423	2.773	854	652

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri